

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>DPE/DMP</b>	Nr. Prot B. Prot Prot No <b>03-2950/12</b>
Nr. i treg. Braj shifra Nr. datës <b>02</b>	Data Datim Datë <b>22-08-2012</b>

**Re.l.nr.636/2012**

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH**, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Lulzim Rifaj nga Dragashi, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1 dhe 3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 14.08.2012, merrë këtë

## **A K T V E N D I M**

I PANDEHURI Lulzim Shaban Rifaj nga Dragashi, Shqiptar, Shtetasë i Republikës së Kosovës, punëtor, me banim të përherëshëm në Dragash.

## **ËSHTË PËRGJEGJËS**

Për arsye se si zyrtar i lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31.mars të vitit 2012, nuk e ka përbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formullarin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit.

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1/3 të Ligjit nr.04/L-050, e në bazë të kësaj dispozite e konform nenit 10 të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe i pandehuri,

## **DENOHET**

### **ME QORTIM.**

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmesë kësaj Gjykate.

## **A r s y e t i m**

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë. 01-2154/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Rifaj me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

I pandehuri Lulzim Rifaj në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësiaht për mes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formullarin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Ka deklaruar se me të u njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me datën 02.08. 2012 e ka paraqit formullarin dhe njëherit e ka bërë deklarimin e pasurisë. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes dhe marrëjes së aktvendimit të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejnë si rethana letësuese.

03-2950/12/02  
Sugj


Gjykata ka lexuar shkresat se lëndës të Agjencionit kundër korupcionit, deklaratën e të pandehurit, deshmit e prezentuara dhe pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se i pandehuri Lulzim Rifaj si zyrtar publik i obliguar për ta deklaruar pasurin, në afatin e përcaktuar ligjor si në dispozitiv nuk e ka plotësuar dhe nuk i ka dërguar formularin Agjencionit më së voni deri më dt.31.03.2012.

Me këto veprime ka kryer kundërvajtje të sanksionuar me nenin 17 pika 1 dhe 3 të Ligjit nr/04/L-050

Gjykata ndaj të pandehurit konform nenit 10 të LMK-së e ka bër zbutjen e denimit nga rrethanat, se i pandehuri për herë të parë ka kryer kundërvajtje të kësaj natyre, se nuk ka qenë i informuar mirë me Ligjin nr. 04/L-050 dhe obligimet sipas këtij Ligji, se me të njoftuar me obligimin Ligjor me dt.15.06.2012 përmes formularit e ka bër deklarimin e pasuris.

Me sa u tha me lartë është vendosur si në dispozitiv të keti aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË  
DRAGASH, Me datën 14.08.2012, Re.I.nr.636/2012



Gjykatari për kundërvajtje,  
Bekim Vehapi

**KËSHILLA JURIDIKE;** kundër këtij aktvendimi parashtrohet i kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejten e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksa përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.